

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Bsc në Psikologji e Përgjithshme

në Universitetin Privat Albanian University

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm: Prof Asoc. Dr Arjana Mucaj

(06/2017)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në Psikologji e Përgjithshme
(Bachelor in General Psychology)

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASH Nr. 8981 Prot, datë 27.12.2005
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Akreditimi i parë: Urdhër Nr. 355, datë 03.11.2009 (Akreditim, me kusht sipas: VKA Nr. 50, datë 27.10.2009) (*) Akreditimi pa kushte: Urdhër Nr. 541, datë 01.12.2010 (Vlerësuar në kuadër të heqjes së kushteve: VKA Nr. 99 datë 29.10.2010)
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Psikologji e Përgjithshme
6	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
16	Aktivizimi i programit të studimit	2005
17	Numri i studenteve sipas brezave në periudhën 2010-2017)	Viti akademik 2010-2011 37 Viti akademik 2011-2012 32 Viti akademik 2012-2013 63 Viti akademik 2013-2014 57 Viti akademik 2014-2015 60 Viti akademik 2015-2016 64 Viti akademik 2016-2017 94 (46 në Tirane + 48 Filiali Berat)

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

(*) Akreditimi i parë për këtë program studimi ka dalë me kusht dhe pas plotësimit të kushteve, brenda afateve të percaktuara në Urdhër përkatës të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, programi ka marrë akreditimin e plotë.

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Psikologji e Përgjithshme

Programi Bachelor në Psikologji të Përgjithshme, i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në Universitetin Privat "Albanian University", është akredituar me Urdhër Nr. 355, datë 03.11.2009 (Akreditim, me kusht sipas VKA Nr. 50, datë 27.10.2009). Akreditimi i parë për këtë program studimi ka dalë me kushte dhe pas plotësimit të kushteve, brenda afateve të përcaktuara në Urdhrin përkatës të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, programi ka marre akreditimin e plotë me Urdhër Nr. 541, datë 01.12.2010 (mbështetur në VKA Nr. 99 datë 29.10.2010)

Akreditimi me Urdhër Nr. 541, datë 01.12.2010 të MASH ka dalë pa kushte dhe rekomandime.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof Asoc. Dr. Arjana Mucaj

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL dhe miratimi i përbërjes së tij në Bordin e Akreditimit, me Urdhër nr. 48, datë 07.06.2017. Nga ASCAL mori pjesë specialistja Znj. Renata Qatipi.

Institucioni "Universiteti Privat Albanian University" me shkresë Nr. 206/1 Prot, datë 07.07.2017 "*Kthim përgjigje për draft-Raportin e programit bachelor në Psikologji e Përgjithshme*" ka sjellë në APAAL komentet lidhur me Draft RVJ, në mbështetje të së cilës u saktësua Tabela nr. 4, që ka të bëjë anëtarët e Njesisë së Brëndshme të Sigurimit të Cilësisë (faqe 16).

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

Akreditimi i parë i Programit të studimit në Psikologji të Përgjithshme në Universitetin Privat Albanian University ka dalë me kusht dhe pas plotësimit të kushteve, brenda afateve të përcaktuara në urdhrin përkatës të ministrit të arsimit dhe shkencës, program ka marrë akreditimin e plotë, pa kushte dhe rekomandime.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Programi i studimit në BSc Psikologji e Përgjithshme në Universitetin Privat "Albanian University" (AU) ka në qëllimin e tij përgatitjen e psikologëve të rinj si profesionistë në fushën e psikologjisë. Studentët që mbarojnë këtë cikël studimi duhet të jenë të aftë të trajtojnë me profesionalizëm dhe etikë problemet psiko-sociale, me të cilat ndeshet shoqëria shqiptare. Përsa i takon objektivave në mësimdhënie bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm referuar në fq.4 mendoj se mësimdhënia në ciklin e parë të studimeve ka pasur një zhvillim cilësor nga viti 2010- 2017, duke i orientuar studentët drejt ofrimit të kompetencave, gjë e cila ecën përkrah linjës së procesit të Bolonjës. Mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm fq. 6, konstatohet se Kërkimi Shkencor është një tjetër përparësi në rritjen e cilësisë profesionale të stafit akademik. Forma e

bashkëpunimit me studentët është një përparësi, pasi i mëson ata me aftësitë metodologjike për kërkimin shkencor. Gjatë këtyre viteve Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka në planin e tij objektiva afatshkurtra, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave/moduleve, por jo vetëm, por edhe me përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor, kjo në bashkëpunim me stafin akademik. Prioritet kryesor sipas asaj që është paraqitur në RVB është dhe shtimi i numrit të institucioneve me të cilat, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Përsa i takon strategjive afatgjata Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në institucionin e Albanian University, ka parashikuar ngritjen e një klinike komunitare, ku baza e saj do të jenë shërbimet psiko-sociale, që do të shërbejnë si një shtysë për ushtrimin e praktikave nga studentët e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme.

Duke u mbështetur në RVB objektivat dhe qëllimet e programit të studimit Bsc Psikologji e Përgjithshme, ndërtohen në përputhje me objektivat dhe qëllimet e Albanian University, dhe janë në funksion të tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Ky program studimi është në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit për promovimin dhe organizimin e kerkimit shkencor në përhapjen e dijes në shkencat shoqërore. Mbështetur në raportin e vlerësimit të brëndshëm fq. 4 u konstatua se misioni i tij është formimi i përgjithshëm i psikologëve të rinj për t'i përgatitur ata në vazhdimin e studimeve të mëtejshme në ciklin e dytë të studimeve në psikologji. Objektivat e programit të studimit në Bsc Psikologji e Përgjithshme, u konstatuan se janë të përcaktuara qartë mbi përgjegjshmërinë e formimit të studentëve, rritjen e kompetencave profesionale të cilat studentët i realizojnë gjatë gjithë ciklit të parë të studimit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Psikologji të përgjithshme në Albanian University është i përshtatur me strategjinë e institucionit. Mbështetur në RVB fq. 11, kjo strategji hartohet me qëllim për të qenë e pajtueshme me prirjet kryesore të zhvillimit të Albanian University në Europë dhe në Botë në vecanti me procesin e Bolonjës.</p> <p>Ky program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuritë bazë të cilat do të shërbejnë si themel për formimin e zhvillimit të mëtejshëm të studentëve në fushën e psikologjisë, gjatë programeve të ciklit të dytë, apo të tretë të studimeve. Mbështetur në raportin e vlerësimit të brëndshëm fq. 12 programi i studimit në Bsc Psikologji e Përgjithshme, ndërton bazat për aftësimin që do të profilizohet e thellohet</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

	<p>në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve.</p> <p>Programet e ofruara në Albanian University mbulojnë një gamë të gjerë profesionale e specialitetesh, në përputhje me kërkesa e tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik të vendit.</p>
--	---

II ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Mendoj se, programi i studimit në BSc Psikologji e Përgjithshme në AU, ka marrë parasysh nevojat e tregut të punës për përgatitjen e profesionistëve të rinj në fushën e psikologjisë. Ky program ju ofron studentëve trajnimin e përshtatshëm dhe të nevojshëm që studentët të përgatiten për profilizimin e mëtejshëm në tregun e punës.</p> <p>Programi në Bsc Psikologji e Përgjithshme është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, i cili kërkon një orientim përkundrejt shërbimeve psikologjike cilësore të ndihmuara këto dhe nga ngritja e Urdhrit të Psikologut ne Rep. e Shqipërisë.</p> <p>Mbështetur në RVB fq.12 hapësira studimore e nevojave të tregut të punës në nivel ndërkombëtar është disi e limituar. Në lidhje me nevojat dhe vlerësimet për arsimim, Albanian University kryen një vëzhgim të situatës në vitin aktual duke bërë një parashikim për vitin pasardhës</p>
---	--

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Psikologji të Përgjithshme në Albanian University referuar RVB fq. 13 nuk bie ndesh me interesat kombëtare, në të kundërt është në përputhje të plotë me to, duke synuar formimin e brezit të ri të profesionistëve në fushën e studimeve psiko-sociale, e domosdoshme kjo për zhvillimin njerëzor të shoqërisë shqiptare.</p>
--	--

Konkluzione të GVJ:

Referuar Raportit të Vlerësimit të Brëndshëm, Standartet I – II vazhdojnë të jenë të plotësuara në misionin dhe objektivat që Institucioni Albanian University ka për Programin Mësimor në Bsc Psikologji e Përgjithshme. Ky program studimi është në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit Albanian University për promovimin dhe organizimin e kerkimit shkencor në përhapjen e dijes në shkencat shoqërore.

Duke ju referuar RVB por edhe vizitës së kryer, me rezulton se misioni i tij është formimi i përgjithshëm i psikologëve të rinj për t'i përgatitur ata në vazhdimin e studimeve të mëtejshme në ciklin e dytë të studimeve në psikologji. Vetë institucioni i Albanian University (AU), vit pas viti kryen një vëzhgim të tregut të punës ku rishihen mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas por edhe atë rajonal dhe ndërkombëtar, kjo edhe për efekt të bashkëpunimeve që institucioni Albanian University ka me bashkëpunëtorë të huaj, të cilët i përkasin fushës së psikologjisë. Ky program studimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por është në përputhje të plotë me to, pra për të kontribuar me një brez të ri profesionishtësh në fushën e shërbimeve psiko- sociale.

Programi i studimit në Psikologji të Përgjithshme, synon të mbrojë interesat dhe vlerat kulturore kombëtare, referuar dokumentacionit të paraqitur në Institucionin e Albanian University dhe

referuar dhe RVB konstatova që Institucioni Albanian University i plotëson plotësisht standartet e lartëpërmëndura.

2. Struktura akademike e Fakultetit përgjegjës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është njësi kryesore në Institucionin e Albanian University (AU), i cili organizon dhe drejton procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Fakulteti i Shkencave Shoqërore duke ju referuar RVB përbëhet nga katër Departamente:

- **Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme,**
- Departamenti i Shkencave Juridike,
- Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, si dhe
- Departamenti i Politiko Administrative.

Seicili Departament ka në përbërjen e tij një numër prej 7 ose më shumë pedagogësh me kohë të plotë.

Referuar RVB (aneks nr 2, 3, 4) Organet drejtuese janë: Dekani, z/Dekani, Përgjegjesi i Departamentit dhe Drejtuesi i qendrës kërkimore. Po ashtu, referuar RVB fq. 14 organ drejtues është dhe Këshilli i Fakultetit.

Departamenti përbëhet nga Përgjegjësi i Departamentit, stafi akademik efektiv (PAE) dhe stafi akademik me kontratë (PAK). Përgjegjësi është dhe funksionari më i lartë drejtues i njësisë, i cili organizon dhe kordinon punën mësimore dhe kërkimore në Departament. Përgjegjësi propozohet nga senati dhe emërohet nga Administratori i Albanian University (AU). Mandati i tij është 4-vjeçar. Të gjithë këta aktorë kanë një bashkëpunim korrekt në marrëdhënie e tyre të punës sidomos në cdo fillim viti Përgjegjësi i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme bashkëpunon dhe me Departamentet e tjera të Fakultetit mbi shkëmbimin e stafit akademik, sipas nevojave të Departamentit mbi bazën e kurrikulave që mund të mbulohen prej tyre.

Referuar RVB fq.16 personeli akademik përbëhet nga pedagogë me kohë të plotë, ato me kontratë, si dhe nga personeli i ftuar ku përfshihen lektorët dhe profesorët.

Në Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme ka 11 Pedagogë me kohë të plotë (PAE) dhe 9 Pedagogë me kohë të pjesshme (PAK). Përsa i takon pedagogëve me kohë të plotë, ka 6 pedagogë me gradën shkencore Doktor, 3 pedagogë janë në proces së marrjes së gradës shkencore Doktor dhe 2 janë me titullin Master Shkencor. Personeli akademik me kohë të pjesshme gjithashtu është me tituj dhe grada shkencore, përkatësisht 1 është me titullin Profesor Doktor, 2 janë me titull Profesor i Asociuar, 2 janë me gradën shkencore Dr dhe 3 janë në proces së marrjes së gradës Doktor dhe një me titull Master Shkencor.

Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen me kontratën e punës dhe në rregullore. Personeli akademik mund të angazhohet edhe në punë të tjera të natyrës administrative, në ndihmë të nevojave të Universitetit. Mbështetur në fq.20 në RVB kontratat nënshkruhen me pedagogë efektiv dhe me kontratë dhe administrohen nga zyra e burimeve njerëzore. Kjo zyrë është përgjegjëse jo vetëm për arkivimin e dokumentacionit dhe ruajtjen e tyre në vite por edhe për gjenerimin e statistikave vjetore dhe semestrale të cilat deklarohen në organet/institucionet me të cilat Albanian Universityka bashkëpunim. Në fillim të seicilit vit akademik/semestër zyra e burimeve njerëzore bën përditësimin e informacionit mbi stafin akademik me kontratë dhe efektiv. Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore u njoha me dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. U panë modelet e kontratave të punës të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe në mënyrë të rastësishme u përzgjodhën për t'u

parë dosjet personale të personelit me kohë të plotë dhe të pjeshme. Kjo për të konstatuar nëse janë të plotësuar me dokumentacionin përkatës dosjet e personelit akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Nga gjëndja e konstatuar në Universitetin Albanian University, krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në raportin e vlerësimit të brëndshëm RVB për treguesit hierarkik të Fakultetit dhe të Strukturës Akademike të Fakultetit evidentoj se nuk ka ndryshime të cilat të ndikojnë në përmbushjen e standarteve. Të dhënat e konstatuara plotësojnë standartet.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Referuar raportit të vlerësimit të brëndshëm fq. 20 si dhe dokumentacionit të paraqitur në institucion, personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi zotëron kualifikime të ndryshme për specialitetin e lëndës që ofron, si dhe eksperiencë të gjatë, jo vetëm në mësimdhënie por edhe në profile e punës së tyre. Personeli akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2016-2017 është rritur, kjo dhe për faktin se duhet të mbulojë 70% të ngarkesës mësimore. Ky program studimi mbulohet nga personel akademik efektiv dhe me kontratë, PAE dhe PAK, por edhe nga akademik të ftuar i cili shërben për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

Të drejtat dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre rregullohen me kontrata e punës. Sipas dokumentave të paraqitura në RVB por edhe dokumenteve plotësuese të kërkuara në institucion, për vitin akademik 2016 – 2017, numri i personelit akademik efektiv (PAE) është 11, kurse numri i personelit PAK është 9. Ngarkesa mësimore e personelit akademik me kohë të plotë është e mbështetur në normën mësimore prej 250 orësh vjetore. Ngarkesa mësimore tregon se nuk ka mbingarkesë për stafin akademik. Mbështetur në dokumentacionin e dhënë gjatë vizitës personeli akademik efektiv PAE përgjatë viteve akademike 2010 - 2017 është i paqëndrueshëm dhe kjo ka shumë faktorë që në shumicën e rasteve janë të brëndshëm por edhe të jashtëm. Kjo është një nga pikat e dobta të institucionit AU në programin e studimit në Psikologji e Përgjithshme. Referuar dhe të dhënave të paraqitura në tabela rezultojnë një paqëndrueshmëri e stafit akademik efektiv. Sipas pasqyrës që paraqitur në RVB raporti personel akademik efektiv/personel administrativ/ student për vitet akademike nga 2010 – 2017 rezultojnë si me poshtë:

Viti akademik 2010-2011	28/7/37
Viti akademik 2011-2012	24/7/32
Viti akademik 2012-2013	25/7/63
Viti akademik 2013-2014	25/7/57
Viti akademik 2014-2015	34/7/60
Viti akademik 2015-2016	37/7/64
Viti akademik 2016-2017	38/7/94 (46 në Tirane + 48 transferuar nga Filiali Berat)

Universiteti përcakton dhe kriteret e rekrutimit që kandidatët duhet të përmbushin. Universiteti ruan të drejtën për të vendosur kriteret e vecanta sipas pozicionit dhe përshkrimit të punës. Këto të dhëna u konstatuan nga dokumentacioni dhe rregulloret e paraqitura në institucion gjatë vizitës. Kandidati i përzgjedhur i nënshtrohet një periudhe prove deri në 3 muaj në mbarim të së

cilës përcaktohet nëse marrëdhënis e punës do të vazhdojë apo do të ndërpritet. Këto marrëdhënie rregullohen me kontratat e punës mbështetur në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Rep. e Shqipërisë", dhe në Kodin e Punës. Referuar RVB aneksi nr.17 pasi është shpallur kandidati fitues nga përzgjedhja ai nënshkruan kontratën e punës pa afat, e cila shkruhet nga Administratori dhe i punësuarit, pasi ky i fundit është vënë në dijeni për kushtet e kontratës, të drejtat dhe detyrimet ligjore që lindin pas firmosjes së saj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Institucioni në RVB si dhe ne dokumentacionin shtese te kerkuar gjate vizites, ka paraqitur të dhëna e personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme për vitet akademike 2010 deri ne 2017 (shih RBV faqe 53). Më poshtë kemi paraqitur të dhënat e stafit akademik të viti aktual akademik.

Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) viti 2016 - 2017

Për programin Bsc në Psikologji të Përgjithshme							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Elisabeta Kafia	Drejtuës e Departamenti	Dr	1	Ethem Ruka	ProfDr	
2	Brunilda Laboviti	Pedagog e	Dr	2	Artemisi Shehu	Prof As	Fakulteti i Shkencave Shoqërore, UT
3	Desara Agaj	Pedagog e	Dr	3	Eltjon Halimi	Prof As	Fakulteti i Shkencave të natyrës, UT
4	Valbona Treska	Pedagog e	Dr	4	Arben Hoti	Dr	Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër
5	Dritan Taulla	Pedagog	Dr proces	5	AlmentMuho	Dr	Fakulteti i Shkencave Shoqërore, UT
6	IrenaHysenaj	Pedagog e	Dr proces	6	Redina Balla	Dr proces	Psikologe Shkolle, Drejtoria Arsimore Rajonale, Tiranë
7	Silva Ibrahimimi	Pedagog e	Dr proces	7	Manjola Çollaku	Dr proces	
8	Gejsi Ndoja	Pedagog e	Msc	8	Kris Koçi	Msc	
9	LorelaGaruli	Pedagog e	Msc	9	Elona Mehmeti	Dr proces	AU, FSHM
10	Bledar Kurti (pedagog i brendshëm për FSHSH)	pedagog	Dr	10			
11	ErvinKaçiu (pedagog i brendshëm për FSHSH)	pedagog	Dr	11			

Titulli	Stafi akademik i programit të studimit		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	1	1	1/1
Profesorë të As.	1	4	1/4
Doktorë	4	8	4/8
Docentë			
Pedagogë ne proces Dr	7	4	7/4
Asistentë me Ma			
Personeli Administrativ	2	-	2/0

Krahasuar me të dhënat e deklaruara nga institucioni i arsimit të lartë Albanian University dhe nga gjëndja e konstatuar në Institucion për treguesit e tabelës nr. 2 dhe nr. 3 (për vitet 2010 deri 2017) evidentoj se stafi akademik me kohë të plotë nga viti në vit ka paqëndrueshmëri, kjo për shumë faktorë të brëndshëm dhe të jashtëm. Kjo paqëndrueshmëri ndikon më shumë në cilësinë e mësimdhënies por jo në atë të përmbushjes së standardeve.

Gjithashtu nga tabela e paraqitur nga Institucioni për ngarkesën mësimore të pedagogëve me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme del në pah ngarkesa mësimore e një pedagogeje me kohë të pjesshme që është mbi normën mësimore të përcaktuar pra me 720 orë mësimore. Përsa i takon pedagogëve të tjerë janë brënda normës mësimore për një vit akademik. Pra në këtë pikë Institucioni i ka standardet pjesërisht të plotësuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik referuar RVB por edhe bisedave të realizuara përkon me një procedurë transparente dhe me nje procedurë ligjore në përputhje me statutin dhe rregulloren e vetë institucionit.</p> <p>Përsa i takon vitit akademik 2016- 2017 personeli akademik me kohë të plotë mbulon me 74.1 % programin e studimit në Psikologji e Përgjithshme</p>
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor, ose titullin akademik "Docent,,".</p>	<p>Pra kjo shifër e pedagogëve me kohë të plotë ka ardhur në rritje që nga viti 2010, gjë që tregon dhe përgjeshmërinë e institucionit për të forcuar pozitat e Departamentit dhe ruajtjen e vlerave në kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik.</p> <p>Duke ju referuar dhe tabelave të paraqitura në RVB nr. 2, nr. 3, (për vitet 2010 deri 2017) vë re një paqëndrueshmëri të stafit akademik efektiv. Kjo është e ndikuar nga shumë faktorë të brëndshëm dhe të jashtëm.</p> <p>Duke u mbështetur në RVB dhe dokumentacionit të paraqitur në institucion mendoj se, institucioni ndjek procedura transparente të vlerësimit të personelit. Rezultatet në fund të procesit të vlerësimit i bëhen të njohura si Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme po ashtu dhe Rektorit, te cilët në bashkëpunim marrin masat për të rregulluar ato anomali që dalin në pah.</p> <p>Referuar RVB, institucioni ruan nje bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit si dhe të</p>

	<p>njoftimeve të bëra mbi rekrutimin e personelit akademik si me kohë të plotë dhe të jo të plotë.</p> <p>Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore u njoha me dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme. U panë modelet e kontratave të punës të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjeshme. Në mënyrë të rastësishme u përzgjedhën për tu parë dokumentat e personelit me kohë të plotë dhe të pjeshme. Kjo për të konstatuar nëse janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dosjet e personelit akademik.</p> <p>Në zyrën e burimeve njerëzore konstatova listën e plotë të personelit të angazhuar, e cila ruhet në këtë institucion për simester dhe vjetore për secilin anëtar të rekruar në programin e studimit Bsc Psikologji e Përgjithshme. Kjo përfshinte periudhën nga 2010-2017.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Programi i studimit në Psikologji të Përgjithshme nuk aplikon orë laboratorike dhe nuk ka në përdorim laboratorë, kjo dhe për vetë specifikën e fushës së studimit. Referuar kjo në RVB, por edhe konstatimit e bërë në institucion.</p> <p>Duke ju referuar raportit por edhe dokumentave të paraqitura angazhimi I stafit akademik në këtë program studimi në Bsc Psikologji e Përgjithshme konstatova se ka raste të mbingarkesës mësimore të stafit akademik të ngarkuar jo vetëm në këtë program studimi por edhe në programe të tjera.</p> <p>Një nga pikat të cilën Departamenti e quan si pikë e fortë është pikërisht realizimi i praktikës, si një praktikë, e cila i shëtiste studentët nga një institucion në tjetrin, gjatë gjithë zhvillimit të saj. Kjo shihet shumë pozitive nga studentët, pasi njihen me institucionin përkatës për të krijuar dhe një ide sa më të qartë se çfarë drejtimi do të duan të marrin për t'u përgatitur në studimet e mëtejshme në fushën e psikologjisë.</p> <p>Personeli i mbikëqyrjes përbëhet nga pedagogë të përzgjedhur për të monitoruar dhe supervizuar praktikën.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Personeli akademik ka një mbështetje të plotë për kualifikim e tyre të mëtejshëm, kjo e pasqyruar me pjesëmarrjen e tyre në konferenca dhe seminare si brënda dhe jashtë vendit dhe e mbuluar financiarisht nga vetë institucioni. Një mbështetje për botimet shkencore është dhe botimi i artikujve në revisten "Optima", por edhe mbulimi i shpenzimeve në botimin</p>

e librave me interest në fushën e psikologjisë. Referuar kjo sipas (RVB) dhe takimit me stafin akademik.

Institucioni disponon një bazë të dhënash për të gjitha programet e studimit që ofron. Referuar RVB fq.25 Departamenti gjithashtu i ruan këto të dhëna për të gjitha programet e studimit që ofron, duke filluar që nga licensimi e deri tek të dhënat personale të studentit për secilin program studimi, si edhe për pedagogët e angazhur në këtë program studimi BSc Psikologji e Përgjithshme.

Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u njoha me regjistrin themeltar të studentëve si dhe me vlerësimet e marra në lëndë të ndryshme mësimore. Gjithashtu na u paraqit dhe lëvizja e studentëve nga filiali i qytetit të Beratit në njësinë qendrore Tiranë, për vazhdimin dhe mbylljen e studimeve të tyre në ciklin e parë të studimeve. Gjithashtu në mënyrë të rastësishme përzgjedhëm dhe disa student ku u verifikuan notat e regjistrimit me proces verbalet perkatëse.

Konkluzione të GVJ:

Sipas konstatimit të bërë gjatë vizitës në institucion, standartet III, III-1, III-2, III-4 kanë ardhur duke u përmirësuar, gjë e cila pasqyrohet dhe me rritjen e numrit të stafit akademik me kohë të plotë, për një cilësi edhe më të mirë të mësimdhënies. Rekrutimi i stafit akademik përkon me një procedurë transparente dhe me një procedurë ligjore në përputhje me statutin dhe rregulloren e vetë institucionit, kjo referuar edhe në RVB.

Përsa i takon vitit akademik 2016- 2017 personeli akademik me kohë të plotë mbulon me 74.1 % realizimin e programit të studimit. Shifra e pedagogëve me kohë të plotë ka ardhur në rritje që nga viti 2010, gjë që tregon dhe përgjeshmërinë e institucionit për të forcuar pozitën e Departamentit dhe ruajtjen e vlerave në kualifikimin e mëtjeshëm të stafit akademik. Duke ju referuar raportit por edhe dokumentave të paraqitura angazhimi I stafit akademik në këtë program studimi në Bsc Psikologji e Përgjithshme konstatova se ka raste të mbingarkesës mësimore të stafit akademik të ngarkuar jo vetëm në këtë program studimi por edhe në programe të tjera.

Ajo që institucioni nuk e paraqet në raportin e vlerësimit të brendshëm është lëvizja e stafit akademik me kohë të plotë nga 2010- 2017, kjo për një sërë faktorësh të jashtëm por edhe të brendshëm. Kjo u konstatua dhe nga dokumentacioni i paraqitur në institucion. Institucioni ruan një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit si dhe të njoftimeve të bëra mbi rekrutimin e personelit akademik si me kohë të plotë dhe të jo të plotë.

Në zyrën e burimeve njerëzore konstatova listën e plotë të personelit të angazhuar, e cila ruhet në këtë institucion për simestër dhe vjetore për secilin anëtar të rekrutuar në programin e studimit Bsc Psikologji e Përgjithshme. Kjo përfshinte periudhën nga 2010- 2017.

Personeli akademik ka një mbështetje të plotë për kualifikimin e mëtjeshëm, kjo e pasqyruar me pjesëmarrjen e tyre në konferenca dhe seminare si brenda dhe jashtë vendit, si dhe e mbuluar financiarisht nga vetë institucioni.

Stafi ka një mbështetje maksimale për të pasqyruar botimet në revisten "Optima", por edhe në mbulimin e shpenzimeve në botimin e librave me interest në fushën e psikologjisë. Edhe pse paqëndrueshmëria e stafit në vite vazhdon të shihet si dobësi, institucioni i plotëson pjesërisht standartet III, III-1, III-2, III-3, III-4.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkimore

Gjatë vizitës në institucionin e AU, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, na prezantoi një infrastrukturë të mjediseve në të cilat zhvillohen leksionet dhe seminarët. Këto mjedise janë të pajisura me mjetet audio-vizive për të lehtësuar procesin e mësimdhënies në auditore. Departamenti ka salla të bollshme për të realizuar programin e studimit në BSc Psikologji e Përgjithshme. Gjithashtu klasat janë të pajisura me tryeza pune dhe karrige të rehatshme për të lehtësuar qëndrimin e studentëve gjatë orëve të leksioneve dhe seminarëve. Salla e bibliotekës online është e pajisur me kompjutera, ku çdo student mund t'i përdorë lehtësisht ato për të nxjerrë informacionet e duhura mbi punët e tyre kërkimore.

Rrjeti i kompjuterave që përdoren nga studentët, stafi akademik dhe punonjësit e administratës janë të lidhura me internetin në të katër godinat e Albanian University. Referuar RVB fq. 28 Biblioteka on - line ka dhe simotrën e saj bibliotekën me gjendje fizike librash të fushës së psikologjisë por edhe me libra të fushave të tjera. Fondi i bibliotekës pasurohet çdo fillim viti akademik, duke u bazuar në kërkesat që burojnë nga Departamentet dhe nga studentët me literaturë profesionale si në gjuhën shqipe dhe ato të huaja. Interneti është në dispozicion të orëve të studimit të studentëve, por edhe të kërkimit shkencor të pedagogëve. Biblioteka punon nga ora 8.00 deri në orën 16.00.

Ndërtesa është ekzistuese dhe të gjitha ambjentet e saj janë rikonstruktuar dhe adoptuar në klasa për të plotësuar nevojat e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme. Përsa i takon shërbimeve të tjera për studentët, në ndërtesë ndodhet dhe lokali me vetëshërbim ushqimor, i cili ju krijon lehtësira dhe komoditete studentëve për të mos humbur orët mësimore.

Institucioni për një cilësi më të lartë të infrastrukturës duhet të ndërtojë Kampusin e vet. Gjëndja e konstatuar në institucion tregon se nuk u verejtën ndryshime në treguesit e infrastrukturës, referuar në raportin e vlerësimit të brëndshmëm, që do të thotë se standartet vazhdojnë të jenë të njejtë.

Referuar Rvb fq. 29 zyra e informacionit dhe e recepsionit mundëson dhe shërbimin të çdo informacioni që kërkohej si nga ana e studentëve ashtu dhe e personave të tjerë të interesuar, lidhur me programin mësimor, oraret, numrat e klasave etj.

Gjatë vizitës u konstatua se Institucioni Albanian University nuk disponon ambjente rezidence.

Të dhënat në tabela janë referuar RVB fq. 30

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset e Fakultetit	Sasia	Sip. në metër katror
Sallë për leksione	10	1120.2
Klasa për seminare	20	1005
Salla për aktivitete promovuese	1	245
Laboratorë	0	0
Salla biblioteka	1	248.6
Mjedis për fotokopje	1	7
Zyrë informacioni për studentët	1	6
Nyje higjieno sanitare	6	106.4

Mjedise per Stafin	Sasia	Sip. në metër katror
Zyra për Dekanin	2	85

Zyra për sekretarinë mësimore	4	83
Zyra për Departament	3	70
Zyra për personel akademik	9	270
Zyrë për financën	2	47
Zyrë për nësinë e SBC	1	34
Salla për mbledhje	1	27.3

Standartet për këta tregues duke ju referuar dhe tabelës nr. 7 fq. 30 në raportin e vlerësimit të brëndshëm janë të plotësuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur në Institucion konstatova se, institucioni ju vë në dispozicion studentëve një bazë materialesh sic janë tekstet mësimore, të cilat studentët i blejnë në librarinë e vetë institucionit, apo i gjejnë në bibliotekën fizike të institucionit, si dhe në bibliotekën on-line "Questia" që institucioni ka.</p> <p>Programi i studimit në BSc Psikologji e Përgjithshme në bibliotekë ka një bazë të plotë materialesh të cilat ju vihen në dispozicion të plotë studentëve që janë pjesë e këtij programi studimi.</p> <p>Përgjegjësi i këtij programi studimi vit pas viti dhe në bazë të nevojave të studentëve planifikon dhe buxhetin e nevojshëm për shtimin e zërave të bibliotekës, kjo në bazë të kërkimeve më të fundit që bëhen këtë fushë. Referuar RVB fq.33</p> <p>Gjatë vizitës në bibliotekë konstatova dhe orarin e përshtatshëm të saj për ti ndihmuar sa më shumë studentët që të kenë mundësi përdorimi sa më të gjerë të bibliotekës si fizike por edhe asaj on-line.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjedisive mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi,</p>	<p>Referuar Rvb fq. 34 dhe nga vizita në Institucion u konstatua se ka një sasi të mjaftueshme të mjeteve audiovizive që i vijnë në shërbim. Institucioni ka klasa të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike. Të gjitha pajisjet e mjedisive mësimore ishin të përshtatshme për mësimdhënie kjo në përputhje me qëllimin e vetë programit të studimit në Psikologji e Përgjithshme.</p> <p>Përsa i takon laboratorëve, në këtë program studimi ato nuk janë gjëndje fizike pasi dhe vetë programi i studimit BSC Psikologji e Përgjithshme nuk i ofronet orët laboratorike, referuar dhe RVB fq.35.</p> <p>Zyra e bibliotekës on-line disponon kompjutera si sallë më vetë e cila mund të përdoret nga studentët</p>

programestimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

e këtij cikli studimi por edhe nga student të tjerë të cilet kanë nevojë të navigojnë për informacione të ndryshme.

Duke ju referuar RVB, por edhe dokumentacionit të paraqitur në institucion praktikant kryhen në institucione nëpërmjet bashkëpunimeve korrekte që institucioni Albania University (AU) ka. Kjo garanton dhe zhvillimin sa me të mirë të praktikës.

Konkluzione të GVJ:

Gjëndja e konstatuar në institucion duke ju referuar RVB pasqyron se nuk ka ndryshime në treguesit e infrastrukturës së paraqitur në raportin e vlerësimit të brëndshëm, që do të thotë se standartet vazhdojnë të jenë të njëjta. Sipas dokumentacionit të paraqitur në institucion konstatova se, institucioni ju vë në dispozicion studentëve një bazë materialesh si, tekstet mësimore të cilat mund të blihen në librarinë e vetë institucionit, apo ti gjejn në bibliotekën e institucionin, si dhe në bibliotekën on-line "Questia".

Gjatë vizitës në bibliotekë u konstatua dhe orari i përshtatshëm i saj për ti ndihmuar sa më shumë studentët për të pasur mundësi përdorimi sa më të gjerë të bibliotekës si fizike por edhe asaj on-line. Zyra e bibliotekës on-line dispononte kompjutera si sallë më vetë e cila mund të përdorej nga studentët e këtij cikli studimi por edhe nga student të tjerë të cilet kishin nevojë të navigonin për informacione të ndryshme. Të gjitha pajisjet e mjedisive mësimore ishin të përshtashme për mësimdhënie kjo në përputhje të qëllimit të vetë programit. Sipas konstatimit të bërë por edhe duke ju referuar RVB standartet mbeten të pa ndryshuara.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Referuar RVB fq. 36 burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit. Rreth 1/3 e tyre shpenzohet për qeranë e objektit dhe shërbime të tjera me mirëmbajtje, pastrim, ngrohje dhe ftohje. Pjesa tjetër e të ardhurave shpenzohet për për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brëndshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin e internetit, pajisjet, aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit. Kostoja për student është 1500 euro viti akademik në programin e studimit Psikologji e Përgjithshme. Të gjitha të ardhurat shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Referuar RVB fq. 37 rezulton se të ardhurat kryesore janë nga tarifat e studentëve. Ndërsa shpenzimet ndahen si më poshtë:

Nr	Shpenzime, mësimdhënie dhe shkencë	Njesi matje -lekë	100%
1	Fondi i pagave (a+b)		61.8%
2	Për pagë bazë		
3	Për orët e mësimit		
4	Për kontribute sig.shoqërore		9.2%
5	Për kontribute sig. Shëndetësore		1%
6	Honorar për mësimdhënie		14.6%

7	Për kancelari		8.5%
8	Për veprimtari shkencore		0.85%
9	Fondi i ekselencës		2.9%

Gjëndja e konstatuar në Institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga institucioni në raportin e vlerësimit të brëndshëm (RVB) ku të gjitha të ardhurat shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese, tregon se standartet janë ruajtur për këta tregues.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brëndshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Referuar RVB fq. 37 Institucioni vit për vit bën një audit nga një kontabël i miratuar dhe i rregjistruar për situatën financiare të institucionit.</p> <p>Ky raport përmban të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit si dhe të gjitha shpenzimet operative.</p> <p>Vetë raporti nuk paraqet grante të huaja të fituara nga vetë institucioni por më shumë pasqyron një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>Të ardhurat kryesore janë nga tarifat e studentëve.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Referuar raportit të vlerësimit të brëndshëm Institucioni harton cdo vit një raport i cili përmban të dhëna të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare.</p> <p>Vetë institucioni dokumenton këto raporte financiare për tre vitet e kaluara akademike, gjë që i jep lehtësi të bëj dhe krahasime mbi bilancet financiare.</p> <p>Duke ju referuar RVB fq. 37 Institucioni ka burime financiare të mjaftueshme për gjatë gjithë kohës së zhvillimit të programit të studimit BSc në Psikologji e Përgjithshme.</p>
<u>Konkluzione të GVJ:</u>	
<p>Referuar RVB (aneksi nr.14) si dokument zyrtar, vit për vit bëhet një audit nga një kontabël i miratuar dhe i rregjistruar për situatën financiare të institucionit.</p> <p>Ky raport përmban të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit si dhe të gjitha shpenzimet operative. Ky raport hartohet cdo vit dhe përmban të dhëna të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare.</p> <p>Mbeshtetur në RVB dhe dokumentave të paraqitura në institucion nuk u konstatuan ndryshime në tarifën e shkollimit.</p>	

Përsëri standartet kanë mbetur të pandryshuara.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkimore

Duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur sistemi i brëndshëm i sigurimit të cilësisë (SBSC), funksionon që nga viti 2009. Që nga kjo kohë, Universiteti për të institucionalizuar Sitemin e Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë, ka ngritur strukturën e quajtur Zyra e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë, e cila harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standarteve Shtetërore të Cilësisë të nxjerra nga ASCAL.

Zyra e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë, parashikohet nga neni 18 i Statutit të Universitetit, si një organ i pavarur, i cili ka akses në të gjitha informacionet e Universitetit. Kjo zyrë është në varësi të Rektorit të Universitetit, dhe ka për detyrë paraqitjen e një raporti vjetor në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë. Raporti i paraqitet Rektorit, i cili më tej e përfshin atë në rendin e ditës së Senatit Akademik për diskutim.

Referuar RVB fq. 39 funksinet dhe detyrat e ZSCB, janë parashikuar shprehimisht në nenin 13 të rregullores së brëndshme të Universitetit. Në mbështetje të Statutit, Rregullores, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi. Kjo zyrë ushtron funksion mbështetës, këshillimor, bashkërendues, monitorues dhe administrativ me strukturat e tjera akademike dhe administrativetë Universitetit, si dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.

Sipas RVB fq. 39 por edhe konstatimit në Institucion zyra harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimit dhe modeleve të raporteve vlerësuese, të cilat më tej iu shpërndahen Departamenteve dhe pas plotësimit të tyre prej studentëve apo pedagogëve ZSBC bën përpunimin e të dhënave dhe nxjerr problematikat kryesore, përmirësimet që duhen kryer me qëllim rritjen e performancës së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Me asistencën e Zyrës së Kurrikulave, para cdo fillim viti të ri akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij, analizohen dhe vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënave statistikore, të mbledhura gjatë anketimevetë studentëve, raporteve semestrale të pedagogëve, raporteve simestrale dhe vjetore të departamenteve, si dhe rezultateve të të arritura nga studentët.

Të gjitha këto të dhëna statistikore vihen në dispozicion të ZSBC nga Departamenti dhe sekretaria mësimore gjithmonë duke ju referuar RVB fq.40.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Tabela 4: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Dr. Desara Agaj	Drejtuuese	1 vit
2	Dr. Elona Doko	Anëtare	1 muaj
3	Msc. Sidita Çoniku	Anëtare	1.5 vit
4	Dr. Valbona Treska	Anëtare e NJSBC në nivel Departamenti	10 muaj
5	Dr. Brunilda Laboviti	Anëtare e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti	10 muaj

Të dhënat për punën e zyrës

- Anketime që kanë bërë me studentët – 2 anketime në vit
- Numri i studentëve të anketuar – 46% të studentëve në Programin e Studimit Bsc Psikologji e Përgjithshme
- Janë përpunuar të gjitha anketimet dhe të dhënat që kanë dalë janë sasiore dhe cilësore.
- Departamenti në bashkëpunim me strukturat e tjera të Universitetit ka gjithmonë në vëmendje përmirësimin e standarteve me synim rritjen e nivelit të kënaqësisë së studentëve në lidhje me Institucionin.

Gjëndja e konstatuar në Institucioni e Albanian University (AU), krahasuar më të dhënat ë deklaruar nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm (RVB) për këta tregues Tab.nr.4 (aneks 4), evidentoj se nuk ka ndryshime që lidhen drejtëpërsëdrejti me përmbushjen e standarteve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e 	<p>Referuar raportit të vlerësimit të brëndshëm (RVB) dhe nga dokumentet e paraqitura gjatë vizitës me grupin e vlerësimit të brëndshëm për programen e studimit BSc Psikologji e Përgjithshme, konstatova se përdoren instrumenta matës të standartizuar të detajuara këto në raporte simestrale dhe vjetore.</p> <p>Kjo zyrë vlerësimi i përfshin gjithmonë këto të dhëna dhe në vlerësimin institucional por edhe atë të ecurisë së Departamentit të Psikologjisë.</p> <p>Përsa i takon rezultateve të vlerësimit, institucioni bën publike të gjitha rezultatet e dala nga ky vlerësim, me qëllim përmirësimin e kushteve për vitin pasardhës.</p> <p>Për realizimin e këtij vlerësimi institucioni përdor metoda të drejtëpërdrejta sic janë diskutimet në grup, si me pedagogët, por edhe me studentët, përdor edhe metoda të tërthorta nëpërmjet pyetësorë anonime për të marrë rezultate sa me reale.</p>

- rregulluara);
- b. Dëgjime në auditor;
- c. Vlerësimi me nota/pikë;
- d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;
- e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Etj.

Vëzhgimet janë pjesë e punës së grupit të vlerësimit të brëndshëm.

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Institucioni është në pritje të akreditimit institucional të fillimit të procedurave të akreditimit me agjensinë britanike të vlerësimit. Nderkohë që programi i studimit BSc Psikologji e Përgjithshme është një program studimi i akredituar .

Vetë institucioni përdor manualin e sigurimit të cilësisë me standarte sipas ASCAL. Institucioni kryen në mënyrë periodike dhe sistematike vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të tërthota si përdorimi i pyetësorëve etj.

Përdorimi i mekanizmave formalë për shqyrtimin e dhe miratimin e programit të studimit është një procedurë e punës vjetore të Departamentit të Psikologjisë.

Ndërgjegjësimi i personelit akademik dhe i studentëve që ndjekin këtë program studimi është dhe një nga pikat kyce për të treguar cilësinë dhe rritjen e saj në mënyrë të vazhdueshme.

Kjo tregonte një strategji të mirë të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Këto strategji janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit AU.

Konkluzione të GVJ:

Duke ju referuar RVB gjatë vizitës dhe bisedave me zyrën e sigurimit të brëndshëm të cilësisë konstatova se nuk ka ndryshime nga raporti i vlerësimit të brëndshëm nga institucioni. Mbështetur në RVB grupi i vlerësimit të brëndshëm për programen e studimit BSc Psikologji e Përgjithshme, përdor instrumenta matës të standartizuar dhe këto në raporte janë të detajuara simestrale dhe vjetore.

Kjo zyrë vlerësimi i përfshin gjithmonë këto të dhëna dhe në vlerësimin institucional por edhe në atë të ecurisë së Departamentit të Psikologjisë. Përsa i takon rezultateve të vlerësimit, institucioni bën publike të gjitha rezultatet e dala nga ky vlerësim, me qëllim përmirësimin e kushteve për vitin pasardhës. Institucioni është në pritje të akreditimit institucional me agjensinë britanike të vlerësimit.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Duke ju referuar RVB fq. 45 ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e Institucionit, strategjitë për zhvillimin e Institucionit. Ai është i hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare. Programi i studimit në Bsc Psikologji e Përgjithshme ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij.

Programi i studimit në Psikologji të Përgjithshme është i organizuar në module dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Ky program studimi i ciklit të parë synon pajisjen me njohuritë bazë, metodat e parime shkencore të përgjithshme.

Duke ju referuar RVB, përsa i takon programit Master ka si objektiva thellimin e njohurive që përkohet me profilin e diplomës së Psikologjisë së Përgjithshme, konkretisht disiplinat psikoterapi, psikodiagnostikë, psikologji anormale, duke vendosur specifika për përgatitjen e psikologëve në fushën e shëndetit mendor.

Ky program studimi synon të përgatisë psikologë të aftë për të punuar në; strukturat e shëndetit mendor dhe shëndetësor, spitale, klinika pranë mjekëve të ndryshëm, në strukturat komunitare, në qendrat e shërbimit social, në arsim, në kopshte dhe cerdhe etj.

Qëllimi i kurrikulës së ciklit të parë të studimeve në Psikologji të Përgjithshme është t'u ofrojë studentëve njohuri të cilat do të jenë të nevojshme edhe për tu ndjekur në ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit dhe në të njëjtën kohë t'u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional.

Sipas dokumentave të paraqitura në institucion programi i studimit në Psikologji të Përgjithshme është program studimi i ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 3 vjecare të cilat ju përkohet 180 kredite. Forma e studimit është me kohë të plotë. Programi mësimor është i ndërtuar nga (4580) orë në total, nga të cilat (2040) janë orë studiminë auditor dhe (2540) janë orë individuale. Procesi mësimor është i organizuar në vite akademike, ku në sëcilin vit akademik studenti fiton 60 kredite. Viti akademik zgjat 30 javë. Studenti zhvillon deri në 25 orë mësimore në auditor/javë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Për leksionet 1245 orë në auditor dhe 1478 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 690 orë në auditor dhe 892 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 45 orë në auditor dhe 80 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 60 orë në auditor dhe 90 orë punë e pavarur e studentit

Në Tabelën nr 5 në Aneks të këtij Raporti jepet Plani mësimor në tre vitet e studimit.

Gjithashtu në tabelën 5/1 kemi disa ndryshime për 2 lëndë të planeve mësimore pikërisht lënda Biologji është ndryshuar në Biologji humane dhe lënda Sociologji është ndryshuar në Sociologji e

cila ka kaluar nga sem. II në sem. të parë. Tabela 6 në fund pasqyron planet mësimore lidhur me personelin akademik përkatës referuar dokumentacionit në institucion.

Syllabuse janë të një cilësie bashkohore me parametrat e sistemit të Bolonjës

Gjendja e konstatuar në Institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga vetë Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm (RVB) për këta tregues (Tabelat 5 dhe 6 në RVB), evidentoj se nuk ka ndryshime që të ndikojnë në plotësimin e standarteve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni referuar RVB fq.56 ofron programin e studimit në BSc Psikologji e Përgjithshme si një program të akredituar, me Urdhër nr. 541, datë 01.12.2010 që tashmë është në proces riakreditimi, i organizuar me module dhe të vlerësuara në kredite, sipas sistemit European të Transferimit të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Një vit akademik përkon me 60 kredite.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë në Albanian University (AU), ndjek një praktikë informimi për programin e studimit të ciklit të parë Bsc në Psikologji e Përgjithshme. Duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur në Institucion, Departamenti jep një informacion të detajuar mbi përmbajtjen e këtij program studimi.</p> <p>Studentët marrin një informacion për të gjitha lëndët me zgjedhje, si edhe ato të detyruara, të cilat mund të jene lëndë simestrale ose lëndë vjetore.</p> <p>Studentët atashohen pranë Departamentit ku dhe marrin informacionin e nevojshëm mbi cdo paqartësi, që ata mund të kenë për ngarkesën mësimore, gjë e cila na u pohua nga studentët gjatë takimit të kryer me ta. Kjo është një praktikë që Departamenti aplikon me studentët e secilit vit akademik, duke i mbështetur ata për cdo paqartësi dhe problem që ata kanë.</p>
Konkluzionet e GVJ:	
<p>Duke ju referuar RVB u konstatua se nuk ka ndryshime në standartet e lartpërmëndura. Institucioni ofron programin e studimit në Bsc Psikologji e Përgjithshme si një program të akredituar, i organizuar me module dhe të vlerësuara në kredite, sipas sistemit European të Transferimit të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kjo pasqyrohet dhe në numrin e krediteve për një vit akademik në këtë program studimi.</p> <p>Departamenti i Psikologji në AU ndjek një praktikë informimi për programin e studimit të ciklit të parë BSc në Psikologji e Përgjithshme. Departamenti jep informacion të detajuar mbi përmbajtjen e</p>	

këtij program studimi.

Studentët marrin një informacion për të gjitha lëndët me zgjedhje dhe të detyruara, të cilat janë lëndë simestrale ose lëndë vjetore. Pra përsëri standartet janë të plotësuara.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Sipas dokumentacionit të paraqitur në institucion por referuar dhe raportit të vlerësimit të brëndshëm (RVB) fq. 58, format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet, të organizuara në 22 module, ku janë parashikuar 20 provime, praktika dhe teza e diplomës (provimi i diplomimit).

Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët mund të jenë simestrale dhe vjetore. Puna mësimore organizohet në bazë grupi, kursi dhe nëngrupi. Leksionet zhvillohen në bazë kursi, ushtrimet dhe seminarët zhvillohen në bazë grupi mësimor, leksionet e hapura në gjuhë të huaj dhe praktikat profesionale zhvillohen në bazë nëngrupi mësimor. Ndarja e studentëve në grupe fiksohet në rregjistrat vjetorë të cilët janë dokument zyrtar ku evidentohet zhvillimi i orëve të mësimi nga pedagogët dhe frekuentimi i tyre nga studentët.

Dija e studentit kontrollohet në cdo rast nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm të pedagogut me studentin në formën e bashkëbisedimit, nëpërmjet zhvillimit të testeve ose seancave të kontrollit të dijes. Kontrolli i dijes bëhet me shkrim, me detyra kursi, me gojë. Pedagogu i lëndës përgatit tezat e provimit, të cilat pasi miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit, depozitohen të mbyllura në zarfpranë Departamentit të paktën tri ditë përpara datës së provimit të caktuar.

Referuar RVB fq.58 vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultati i kombinimit të elementëve të mëposhtëm;

1. Provimi përfundimtar 60 pike (60%)
2. Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%)
3. Pjesmarrje aktive në seminarë 10 pike (10%)
4. Ese/prezantim pune në grup 10 pikë (10%)

Vlerësimi bëhet me pikë nga 0 në 100 pikë dhe rezultati përfundimtar kovertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 në 10, ku 4 është notë jo-kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e fituara si dhe shprehet me gëmbra nga A deri në F sipas vlerësimit të ECTS me notë Shih Tabelen fq.59.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Ndarja e orëve mësimore sipas formave të mësimdhënies është si më poshtë: Tab.14, fq. 59

Programi i studimit	Bsc në psikologji të përgjithshme
Forma e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1245
Seminare	690
Praktikë lëndore	45
Provimi përfundimtar	60
Në total	2040

Format e kontrollit të njohurive gjatë vitit janë si më poshtë:

Forma e kontrollit të njohurive	Pjesa (në%) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10 %
Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, laboratorë)	10%
Testime gjatë vitit	20%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

Gjendja e konstatuar në institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga institucioni në raportin e vlerësimit të brëndshëm (RVB) poër këta tregues evidentova se nuk ka ndryshime që të ndikojnë në plotësimin e standarteve.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Referuar RVB fq. 61, kanë të drejtë të aplikojnë për pranimin në ciklin e parë të studimeve shtetasit shqiptarë të pajisur me dokument zyrtar të përfundimit të shkollës së mesme në Shqipëritë ose jashtë saj (eikuvalente sipas kriterëve të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MASH).

Të drejtën për tu pranuar e kanë dhe studentët e huaj bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe. Institucioni zbaton kriteret e vendosura nga MAS dhe përmban, ID, dokumentin zyrtar që vërteton përfundimin e shkollës së mesme, kërkesën për tu pranuar në programin e studimit, formularin e aplikimit, pagesën e kuotës së rregjistrimit. Niveli i notës mesatare në këtë program studimi këto dy vitet e fundit është mesatarja 6 deri në 7. Kjo ka ardhur edhe si arsye e vendosjes së notës mesatare nga MAS.

Kohëzgjatja e studimeve është për një periudhë 3-vjecare, me një total prej 180 kreditesh. Përsa i takon kalueshmërisë së studentëve vihet re një ulje dhe kjo shpjegohet me kalimin nga sistemi i gjimnazit në sistemin universitar.

Studentëve ju vihen në dispozicion nga zyra e këshillimit të karrierës edhe aktorë të ndryshëm të cilët janë faktorë në punësimin e studentëve, por edhe në angazhimin e tyre në kryerjen e praktikës profesionale. Gjithashtu kjo zyrë merret dhe me ruajtjen e të dhënave të studentëve të punësuar që të jenë pjesë e aktiviteteve që institucioni kryen.

Zhvillimi i praktikës nga studentët behet me lëvizje përgjatë 1 semestri nga një institucion në tjetrin. Studentët njihen me institucionin dhe përgatiten për zgjedhjen e fushës ku duan të studiojnë në ciklin e dytë të studimeve.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Periudha e të dhënave	2010 - 2016		
	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (në përputhje jo me diplomën)
Programi i Studimit BSc Psikologji e Përgjithshme	338	58	85 - 90

Për studentët e vitit 2016 nuk ka një shifër për punësimet e tyre, meqënëse sapo kanë përfunduar studimet Bachelor. Numri total i të diplomuarve mund të ndryshojë në përfundim të sesionit të provimeve të vjeshtësqë është duke u zhvilluar.

Programi i studimit në Bsc Psikologji e Përgjithshme	Studentë të rregjistruar në vitin e parë (për herë të parë)	Nota mesatare	Studentë të diplomuar (pa vite përsëritëse)	Nota mesatare
2010	34	6.8	-	-
2011	23	5.9	-	-
2012	20	5.3	-	-
2013	19	5.7	27	8
2014	51	6.96	24	6.96
2015	59	7.3	42	8.5
2016	66	6-7		
2017	94	6-7		
Në total	366	6.32	93	7.82

Referuar RVB tek kolana studentë të diplomuar pa vite përsëritëse, mund të krijohet konfuzion sepse del një numër më i madh studentësh në dalje në krahasim me studentët e rregjistruar, por kjo qartësohet sapo shikon tabelën e transferimeve të bashkëngjitur. Pasi me mbylljen e filialit të Beratit një pjesë e studentëve transferuan studimet e tyre në Tiranë.

Programi i studimit	Largime/transferime	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Totali largime	Totali transferime ne AU
Bsc Psikologji e përgjithshme	Largime	16	1	5	2	1	4	29	
	Transferime	0	1	8	1	66	8		84

Nga vizita në sekretari u gjetën disa tudentë të pamatrikuluar dhe kjo sipas sekretarise ishte për shkak të rregjistrimit të tyre diku tjetër. Për këtë problem po punohet me AKP për t'i dhënë zgjidhje problemit. Gjithashtu është dhe problemi i studentëve të filialit të Beratit pasi MAS nuk e ka miratuar në strukturën akademike të vitit 2016 kete strukture, sepse ka statusin e "I pezulluar". Për këtë arsye është nxjerrë një urdhër për të bërë transferimin e të gjithë studentëve ndërjmetës në Tiranë.

Gjëndja e konstatuar në institucion krahasuar me të dhënat e deklaruar nga institucioni në raportin e Vlerësimit të Brëndshëm (RVB) për këta tregues nuk ka ndryshime që të ndikojnë në përmbushjen e standarteve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi i studentëve në Bsc Psikologji e Përgjithshme referuar (RVB), realizohet në bazë të kriterëve të vendosuar nga MAS, pra mbi kriterin e notës mesatare, e cila lejon futjen e studentit me mesatare mbi 6.00. Kjo behet ne bazë të ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Rep. e Shqipërisë".</p> <p>Kritere pranimi janë vetëm ato të vendosura nga</p>

	MAS.
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Procedura e informimit kryhet si Open Day në institucionin e AU, ku jepet informacioni i nevojshëm mbi programin e studimit në BSc Psikologji e Përgjithshme. Por përdoren dhe mjetet informuese sic është dhe kanali televiziv UFO Televizion, që ky institucion ka.</p> <p>Sipas bisedës së kryer me studentët të viteve të ndryshme, të programit të studimit BSc Psikologji e Përgjithshme, u konstatua dhe vlerësimi që ata i bënëin çdo lënde të programit mësimor dhe kjo kryhej në një periudhë 2- javore para mbylljes së semestrit. Referuar kjo dhe ne RVB. Cdo gjë është anonime ku studentët e plotësojnë pyetësorin on-line.</p> <p>Gjatë bisedës shumica e studentëve treguan se u ofrohej shërbimi i këshillimit të karrierës, nëpërmjet zyrës që ky institucion ka. Shumica e studentëve janë njohur dhe me programet aktuale si Erasmus+, i cili lejon levizjen e studentëve nga një universitet në tjetrin, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale. Për sa i takon programit të studimit në Psikologji të Përgjithshme ende nuk ka lëvizje të studentëve për të përfituar nga bursat e programit Erasmus+.</p> <p>Zyra e karrierës ju jepte një panoramë të qartë mbi mundësitë e punësimit në këtë profesion por edhe ju bënte me dije bashkëpunorët e tyre të cilët mund të kontribuonin në punësimin e studentëve, ose të zhvillimit të praktikës.</p>
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Statistikat vjetore për numrin e të diplomuarve i gjeta në sekretarinë mësimore e cila mban dhe ruan të dhënat për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë të studimit.</p> <p>Gjithashtu sekretaria disponon të dhëna dhe për numrin e studentëve të larguar si dhe për numrin e studentëve të cilët nuk kanë përfunduar këtë program mësimor.</p> <p>Rregjistrat themeltar përmbanin të dhënat kryesore mbi ecurinë e studentit gjatë zhvillimit të programit mësimor që nga moment i pranimit dhe deri në diplomimin e tij.</p>
Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e</p>	<p>Bashkëpunimi student – Zyrë e Këshillimit të Karrierës është pothuajse në çdo moment pasi kjo u pohua në të dyja takimet si me studentët por edhe me zyrën e këshillimit të karrierës, referuar</p>

institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

edhe ne (RVB).

Zhvillimi i praktikës profesionale e vërtetonte më së miri këtë bashkëpunim. Edhe për vetë kënaqësinë që studentët shprehën nga gjetja e një ambjenti familjar në institucionet mikpritëse me të cilat zyra e këshillimit të karrierës bashkëpunonte.

Konkluzionet e GVJ:

Pranimi i studentëve në Bsc Psikologji e Përgjithshme realizohej në bazë të kritereve të vendosuar nga MAS, pra mbi kriterin e notës mesatare, e cila lejonte futjen e student me mesatare mbi 6.00. Kjo behet ne bazë të ligjit Nr. 80/2015, datë 22. 07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Rep. e Shqipërisë”.

Procedura e informimit kryhej si open day në institucionin e AU, ku jepet informacioni i nevojshëm mbi programin e studimit në Bsc Psikologji e përgjithshme. Por përdorëshin dhe mjetet informuese sic është dhe kanali televiziv që ky institucion ka.

Duke ju referuar RVB si dokument zyrtar, konstatova se studentët vlerësimin e bëjnë për cdo lëndë të programit mësimor në një periudhë 2- javore para mbylljes së simestrit. Vlerësimi është anonym, sepse studentët e plotësojnë pyetësorin on-line.

Bashkëpunimi student – Zyrë e Këshillimit të Karrierës është në cdo moment, pasi kjo u konstatua dhe nga dokumentacioni i paraqitur në institucion, por edhe nga takimet si me studentët dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.

Zhvillimi i praktikës profesionale vërteton këtë bashkëpunim. Studentët shprehën kënaqësinë për gjetjen e një ambjenti familjar në institucionet mikpritëse me të cilat, zyra e këshillimit të karrierës bashkëpunonte. Pra edhe në këtë pikë standardet e paraqitura më lart vazhdojnë të jenë të plotësuara.

Gjendja e konstatuar në institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga institucioni në raportin e Vlerësimit të Brëndshëm(RVB) për këta tregues nuk ka ndryshime që të ndikojnë në përmbushjen e standarteve.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Referuar RVB fq. 68 politika në Albanian University në fushën e kërkimit shkencor është në funksion të politikës tërësore të Universitetit dhe të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

Veprimtaria kërkimore shkencore e Albanian University priret, organizohet e zhvillohet në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Rep. E Shqipërisë”. Ajo përqëndrohet kryesisht në hartimin e strategjisë së kërkimit shkencor, që miratohet nga Senati i Universitetit, në realizimin e kërkimit shkencor bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillimin.

Albanian University për të realizuar botimet akademike në gjuhën shqipe dhe të autorëve, akademikëve vendas apo të huaj, krijon dhe vë në funksion njësinë e botimeve akademike AU Press. Referuar RVB fq. 77 pedagogët e angazhuar në mësimdhënie në ciklin e parë të studimeve ndajnë me studentët, në mënyrë sistematike gjetjet nga kërkimi shkencor që ata vetë kryejnë. Ky

aktivitet ka si qëllim të dyfishhtë, nxitjen e të menduarit kritik tek studentët, duke i angazhuar ata në diskutime dhe kritikë të kërkimeve të realizuara.

Kërkimi shkencor nga studentët e programit Bsc në Psikologji e Përgjithshme realizohet, përgjithësisht në kuadër të lëndëve të vecanta që studentët marrin si pjesë e formimit të tyre akademik , nëpërmjet detyrave të kursit, ku atyre u kërkohet të punojnë në mënyrë individuale në mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e tyre.

Sigurisht duke patur parasysh faktin se studentët e ciklit të parë të studimeve janë në nisje të formimit të tyre dhe veprimtaria kërkimore shkencore është në nivela të ulta. Sipas RVB fq.77 kjo veprimtari synon në formimin e tyre dhe të mësuarin me metodologjinë dhe metodat e kërkimit shkencor në psikologji dhe jo në ofrimin e të dhënave të cilat të mund të përdoren në mënyrë totalisht të besueshme, cka lihet për ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Nr	Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në vitet e fundit	
1	Nr. i botimeve PAE	40
2	Nr. i projekteve të fituara	4
3	Nr. i projekteve të zbatuar	4
4	Nr. i aktiviteteve të organizuara nga IAL, për programin e studimit	36
5	Nr. i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brënda IAL	Rreth 500
6	Nr. i kërkimit shkencor më procesin mësimor	Rreth 230
7	Nr. i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	Rreth 100
8	Nr. i cmimeve kombëtare	-

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	3
Për projekte shkencore në rang Departamenti	2
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	6
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerët	5

Gjendja e konstatuar në institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga institucioni në raportin e Vlerësimit të Brëndshëm (RVB) për këta tregues, evidentojse nuk ka ndryshime të cilat të ndikojnë në përmbushjen e standarteve.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Referuar RVB fq. 78, programi i studimit në Psikologji të përgjithshme është multidisiplinar, si pasojë Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka marrëdhënie me shumë Departamente të tjera bashkëpunimi i të cilave është kërkuar për realizimin e lëndëve të specialiteteve të tyre.

Në këtë kuadër është realizuar një bashkëpunim i mirë me Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative, Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes dhe Departamentin e Shkencave Juridike.

Bashkëpunime të tjera janë arritur edhe me stafin akademik i cili jep mësim aktualisht në Universitete të tjera shtetërore dhe private. Nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara në rang fakultetit dhe Universiteti, janë institucionalizuar marrëdhëniet e bashkëpunimit akademik. Referuar dokumentacionit të paraqitur në institucion Albanian University ka lidhur

marrëveshje bashkëpunimi edhe me Universitetet jashtë vendit. Këto bashkëpunime janë një mjet i domosdoshëm për njohjen e ndërsjelltë të kulturave, për zhvillimin kulturor, shkencor të njohurive dhe shpërndarjen e tyre, për të nxitur zhvillimin e projekteve të përbashkëta me interes të ndërsjelltë në fushat e projektuara dhe disiplina të caktuara në drejtim të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë. Mund të përmëndim:

- Marrëveshja me Universitetin e Palermos,
- Marrëveshja me Universitetin e Pizës,
- Marrëveshja me Universitetin e Corvinus, Budapest, Hungari si dhe
- Marrëveshja me Universitetin e L'Aquillas.
- Marrëveshja me Bashkinë e Tiranës, e cila ka lidhje pikërisht me programin e studimit në Psikologji të Përgjithshme

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Aktivitete shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit.

1	Numri i pjesmarrësve si partnerë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare	26
2	Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore)	18 leksione (e-learning + leksione të hapura)
3	Numri i pjesmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	12
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit	84 transferime/32
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	Bibloteka on-line, revistë Optima, Institute for Advanced Psychological Trainig, Tufts Medical Center, Mediterranean Center of Social and Educational Research, Universita degli Studi di bUrbino Carlo Bo.
6	Numri i pjesmarrësve në aktivitete shkencore jashte IAL/jashte vendit dhe prezantime	11
7	Numri i cmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor	-

Gjendja e konstatuar në Institucionin e Albanian University krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm (RVB) për këta tregues nuk ka ndryshime por janë bërë përmirësime. Pra kjo tregon se nuk kemi ndryshime që të ndikojnë në plotësimin e standardeve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRËNDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p>	<p>Referuar RVB fq.84 institucioni ka si politikë nxitjen dhe bashkëpunimin midis personelit brenda institucionit, për mënyrën e shkëmbimit të informacionit. Kjo është e mundur dhe me organizimin e Konferencave, të cilat janë mjaft intensive për të bërë të njohura gjetjet e studimeve nga Departamente të cilët kanë një fushë të përafërt studimi.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p>	<p>Institucioni është përpjekur për të vendosur ura bashkëpunimi me aktorë si vendas dhe të huaj të cilët operojnë në shërbim të shoqërisë. Kjo gjë është e reflektuar dhe me marrëveshjet e lidhura me institucione të cilët i japin një përparësi zhvillimit të praktikave studentore.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p>	<p>Pjesa e suportit mbi mundësitë e trajnimeve profesionale është dhe mbeshtetja që u jep Departamenti si lehtësira për kualifikim stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme cdo vit kryen një raport mbi të cilin shihen rezultatet e bashkëpunimit dhe të realizimit të objektivave që institucioni ka vendosur për partnerët e saj si brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	

Konkluzionet e GVJ:

Referuar raportit të vlerësimit të brëndshëm, institucioni ka si politikë nxitjen dhe bashkëpunimin midis personelit, brenda institucionit për mënyrën e shkëmbimit të informacionit. Institucioni është përpjekur për të vendosur ura bashkëpunimi, me aktorë vendas dhe të huaj, të cilët operojnë në shërbim të shoqërisë.

Kjo gjë është reflektuar me marrëveshjet e lidhura me institucione, të cilët i japin një përparësi zhvillimit të praktikave studentore. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, cdo vit kryen një raport, mbi të cilin shikon dhe rezultatet e bashkëpunimit dhe realizimit të objektivave që institucioni ka vendosur, për partnerët e saj si brenda dhe jashtë vendit.

Kjo tregoi se RVB, nuk kishte ndryshime me ato që konstatova gjatë vizitës.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Gjëndja e konstatuar në Institucionin e Albanian University krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm (RVB) për këta tregues të paraqitur në raport, nuk ka ndryshime por janë bërë përmirësime. Kjo tregon se nuk kemi ndryshime që të ndikojnë në plotësimin e standardeve. Pra standartet janë të plotësuara.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Programet mësimore janë të hartuara sipas moduleve europiane të kurrikulave
2. Studentët janë të kënaqur me punën që Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, bën për integrimin e tyre në karrierën profesionale në tregun e punës
3. Misioni i institucionit është i përcaktuar saktë dhe qartë
4. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka një bashkëpunim shumë të mirë me Departamentet e tjera brënda Institucionit, që operojnë në fushën e shkencave shoqërore
5. Mësimdhënia është e një forme bashkohore, ku përdoren dhe mjetet e teknologjisë dhe informacionit për ta bërë atë sa më interesant

b. Pika të dobëta:

1. Paqëndrueshmëria dhe mbingarkesa e stafit e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme nga viti 2010 e në vazhdim.
2. Shtim i numrit të teksteve mësimore
3. Mungesa në strukturën e Universitetit të zyrës së Këshillimit Psikologjik, e cila është një mbështetje për praktikat profesionale të studentëve.

c. Mundësitë:

1. Ngritja e kapaciteteve dhe mbështetja e stafit akademik me kohë të plotë, që janë në proces të marrjes së Gradës Shkencore, e cila do të fuqizojë Departamentin.
2. Mundësitë për mobilitet akademik në të ardhmen duke krijuar marrëveshje me institucione arsimore ndërkombëtare
3. Përpjekja e Institucionit për të aplikuar për grante ose projekte për zhvillimin e vetë Institucionit

4. Inisiativa që në të ardhmen të ngrihet zyra e Këshillimit Psikologjik, e cila do të jetë një mbështetje për praktikantët profesionale të studentëve dhe për mirëqënien psikoemocionale të studentëve të universitetit.

d. Pengesat:

1. Numri i kufizuar i Psikologëve me tituj dhe grada shkencore në Shqipëri

Rekomandime:

- Programi i studimit në ciklin e parë të studimeve në Psikologji të Përgjithshme e ka shumë të nevojshme, qëndrueshmërinë e stafit akademik me kohë të plotë, pasi ka të bëjë me formimin bazë të studentëve, për përgatitjen e tyre në ciklin e dytë të studimeve.
- Ulja e ngarkesës mësimore të stafit akademik e cila do të ndihmojë stafin akademik në përgatitjen individuale dhe punën kërkimore shkencore
- Ngritja e zyrës së Këshillimit Psikologjik, atashuar në Departamentin e Psikologjisë, e cila do të jetë pjesë lehtësuese e praktikës mësimore të studentëve në këtë program studimi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof Asoc. Dr. Arjana Mucaj